



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Agrium" Sh.P.K. të datës 01.04.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "133 Pikat ushqyese për qentë endacak (furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit) dhe QTE" me nr. të prokurimit 616-24-1368-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Agrium" Sh.P.K. e datës 01.04.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "133 Pikat ushqyese për qentë endacak (furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit) dhe QTE" me nr. të prokurimit 616-24-1368-1-1-1.
- II. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Agrium" Sh.P.K. se tanimë është publikuar Formulari për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara lidhur me kërkesat për kapacitetin teknik dhe/ose profesional në dosjen e tenderit.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Agrium" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Agrium" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 01.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "133 Pikat ushqyese për qentë endacak (furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit) dhe QTE" me nr. prokurimi 616-24-1368-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi 1 "AK ka shkelur nenin, 7 dhe 51 të LPP-së gjatë procesit të administrimit dhe përpilimit duke vendosur kritere që favorizojnë kompani tregtuuese/prodhuese përmes kërkesave të panevojshme dhe të pa përdorura në procedura të ngjashme nga asnjë AK në Republikën e Kosovës. AK në dosjen e tenderit, gjegjësisht në kërkesat e vendosura në FTD në paragrafin e kërkesave "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" ka kërkuar nga OE që të ketë referenca të NJEJTA me procedurën e prokurimit, e cila është e pa precedent që të kërkohet të ketë kontrata të njejta me procedurën e prokurimit".

Pretendimi nr. 2 "AK ka shkelur nenin, 7 dhe 51 të LPP-së gjatë procesit të administrimit dhe përpilimit duke vendosur kritere që favorizojnë kompani tregtuuese/prodhuese përmes kërkesave të panevojshme dhe të pa përdorura në procedura të ngjashme nga asnjë AK në Republikën e Kosovës. AK në dosjen e tenderit, gjegjësisht në kërkesat e vendosura në FTD në paragrafin e kërkesave "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" ka kërkuar nga OE që të ketë ISO 22000:2018, ne mendojmë që është totalisht jo relevante që të kërkohet nga AK ISO 22000:2018 ngase pjesa e "2018" është standardizim i ligjit nëpër vite dhe nuk duhet të kërkohet nga AK".

Lidhur me pretendimin e parë ankimor duhet sqaruar se tanimë është publikuar njoftimi për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara sipas të cilit kërkesa profesionale dhe teknike për të cilën bëhet fjalë është ndryshuar ashtu që tanimë pranohen edhe kontratat me referenca të natyrës së ngjashme.

Sa i përket pretendimit të dytë ankimor duhet cekur faktin se kërkesa për certifikatat ISO ju mundëson operatorëve ekonomik që të dëshmojnë standardin e nevojshëm të cilësisë së punimeve që do të realizojnë në rast se do të shpërblehen me kontratë. Në rastin konkret certifikata ISO e potencuar nga ju, është e domosdoshme dhe në përputhje të plotë jo vetëm me nevojat e njësisë kërkuuese por edhe me qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Pra edhe ky kriter është formuluar në përputhje të plotë me LPP dhe RRPP. Në anën tjetër ju nuk keni parashtruar asnjë argument të vetëm sipas të cilit do të vërtetohej e kundërta. Prandaj ky pretendim është i pabazuar në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur vetëm pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar vetëm si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.04.2024

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.